



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezuar Prilidjen / Profato Received / Delivery	22.04	2022	2	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlopja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMESHCK	2358/2022		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.300/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1213/19 të datës 17.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.57/2019 të datës 29.01.2019 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër protokollit 81/19 të datës 15.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 22.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.57/2019 e datës 29.01.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 29.01.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 522/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 81/19 të datës 15.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli), më datë 30.01.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, ndërsa ky i fundit më datë 11.02.2019 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, përmes shkresës me numër protokollit 1933/2019 të datës 16.04.2019 ka njoftuar ankuesin

lidhur me pamundësinë e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesës së tij të datës 29.01.2019, dhe njeherit ka udhëzuar të njëjtën për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 17.03.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1213/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit [redacted] ka anuluar Njoftimin e Këshillit të datës 16.04.2019 dhe ka detyruar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditësit tani ankuesi të datës 29.01.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 29.01.2019 me numër protokoli 522/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Informimin e datës 25.01.2019 nga Ministria e Administratës Publike për ankuesin; Ankesën me Nr. 192 e datës 23.01.2019 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Emërime në Pozita të Larta Drejtuese; Vendimin me numër protokoli 81/19 të 15.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj; Konkursin e datës 11.10.2018 të shpallur në gazetën ditore "Epoka e Re", nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit"; Formularin MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Vendimin me numër Ref.nr.2766/18 i datës 30.01.2018 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Raporti me numër protokoli 2798/18 i datës 01.11.2018 i Komisionin për Përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm; Ankesën e datës 14.12.2018 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për punësim të kandidatit

[redacted] dhe [redacted] dhe Përgjigja në ankesë nga organi i punësimit e datës 11.02.2019 me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Përgjigje në ankesë e datës 16.04.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë nga ankuesi e datës 30.04.2019; Emailin e datës 08.02.2021 për ankuesin dhe përgjigjen e ankuesit e datës 10.02.2021 dhe Aktgjykimin A.nr.1213/19 të datës 17.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të lëndës, ka konstatuar së është e pabazuar ankesa e ankuesit [redacted] **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji ka konstatuar se Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, më datë 11.10.2018 ka shpall Konkursin me numër protokoli 2490/18 për pozitën e punës *Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit*, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Pas mbylljes së konkursit dhe pranimit të aplikacioneve, Komisioni Përzgjedhës me Raportin me numër protokoli 2798/18 të datës 01.11.2018, ka konstatuar që vetëm njeri nga kandidatet ka plotësuar kushtet formale të konkursit dhe ka propozuar që konkursi në fjalë të rishpallet sepse në listën e ngushtë nuk janë tre (3) kandidatë.

Ankuesi i pakënaqur me Raportin me numër protokoli 2798/18 të datës 01.11.2018 të Komisionit Përzgjedhje, më datë 14.12.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve

dhe Ankesave të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, i cili me Vendimin me numër protokoll 81/19 të datës 15.01.2019 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke dhënë udhëzimi mbi të drejtën e ankesës në Këshillin për Emërime në Pozita të Larta Drejtuese.

Ankuesi, kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, më datë 23.01.2019 ka parashtruar ankesë me Nr.192 në Komisionin për Emërime në Pozita të Larta Drejtuese. Ministria e Administratës Publike më datë 25.01.2019 ka informuar ankuesin që pas vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Pozita të Larta Drejtues, ankuesi nuk ka të drejtë që të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesi pretendon që ka përvojën e punës profesionale të kërkuar dhe së mos kualifikimi në listën e ngushtë bie ndesh me kushtet e konkursit dhe me dispozita e Statusit të USHAF-it.

Bazuar në Konkursin me numër protokoll 2490/18 të datës 11.10.2018 për pozitën e punës *Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit*, si kriteret themelore për këtë pozitë janë përcaktuar: kandidatet të kenë përgatitje universitare Master ose ekuivalente më se paku katër (4) vjet të studimeve, duhet të jetë nga fusha profesionale e drejtësisë, të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë punë profesionale, të ketë aftësi të dëshmuar organizative dhe menaxhuese, të ketë njohuri të mjaftueshme për proceset e arsimit, kërkimeve dhe artit".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ju referua dispozitave të Rregullores Nr.06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenit 21 me të cilin është përcaktuar se: *Në procedurën për emërimin në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përshitatshëm zbatohen dispozitat e përgjithshme për nëpunësit civil të përcaktuara me Ligjin për shërbimin civil dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji"*, ndërlidhur me këtë Kolegji ka analizuar nenin 29 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku shprehimisht është theksuar se: *KPSHC duhet të përgatisë një listë të shkurtër prej së paku tre kandidatëve. Nëse paneli nuk ka mund të identifikoj së paku tre kandidatë për përfshirje në listën e shkurtër, pozita duhet të rishpallet"*. Andaj, mbi këtë bazë ligjore dhe duke u marr parasysh faktin se vetëm një nga kandidatet ka plotësuar kushtet për pozitën e shpallur, atëherë vazhdimi i mëtejme i procedurës rekrutuese me vetëm një kandidat ka qenë i pa mundur ligjërisht, kështu që Kolegji vlerëson së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Bazuar në rrethanat si me lartë, rrjedh së Komisioni Përzgjedhës me rastin e nxjerrjes së Raportit me numër protokoll 2798/18 të datës 01.11.2018 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt depozitat materiale duke vepruar në pajtim me Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.300/2022

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Rektorit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- Sekretarit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- Arkivit të KPMSHCK-së.